



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 28

Prishtinë, më 20.4. 2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL

**I Mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe
Mbiqëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës**

Në mbledhje morën pjesë: Fadil Demaku, nënkryetar i parë; Bojan Mitiq, nënkryetar i dytë;
Anton Quni, Ganimete Musliu, Qerim Bajrami dhe Nuredin Ibishi, anëtarë.

Munguan: Daut Haradinaj, Rexhep Selimi dhe Zafir Berisha.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Përfaqësuesit nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale: Ruzhdi
Jashari, mbikëqyrës kryesor shtetëror dhe Bujar Sadiku, drejtor i përgjithshëm në Agjencinë
Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Pjesëmarrës të tjerë: Fehmi Pireva, zyrtar ndërlidhës me institucionet dhe agjencitë e pavarura,
Kuvendi i Kosovës; Blend Zyrapit-KIPRED; Gent Gjokolli-KIPRED; Vesë Kelmendi-QKSS;
Agesa Haxhiu-KDI; Luanda Domi- DCAF dhe Dhurata Kryeziu-OSBE.

Mbledhjen e kryesoi, Fadil Demaku, nënkryetar i parë i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më datë 30.3.2016;

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30.3. 2016

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015

Kryesuesi, fillimisht fjalën ia dha z. Ruzhdi Jashari, për të prezantuar raportin vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ndërsa më pas anëtarët e Komisionit të parashtrinë çështje dhe pyetje të mundshme.

Ruzhdi Jashari, mbikëqyrës kryesor shtetëror, theksoi se raporti vjetor i Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është përgatitur në bazë të strukturës së kërkuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ku është kërkuar një unifikim në raportim për të gjitha agjencitë e pavarura që i raportojnë Kuvendit. Më tutje, theksoi se sukseset janë treguar tek çështja e ngritjes së kapaciteteve të brendshme të institucionit, siç janë trajnimet, sensibilizimi dhe tek çështja e ngritjes në aspektin profesional të të punësuarve në këtë institucion. Kjo ka ardhur si rezultat i projekteve të mbështetjes të quajtura IPA (Instrumentet Para Anëtarësimit) dhe sipas kontratës ka përfunduar në janar të vitit 2016, por me kërkesë shtesë, mjetet që kanë mbetur nga projektet e IPA-s në Kosovë, janë shtyrë edhe për gjashtë muaj të këtij viti. Gjithashtu, është rritur numri i inspektimeve rreth 15% në sektorin publik dhe në sektorin privat. Agjencia është konsoliduar në aspektin e objektit të punës, në fund të vitit 2015, mirëpo ka nevojë edhe për pak hapësirë shtesë, dhe në të ardhmen, nuk do të ketë probleme sa i përket hapësirës së punës. Ndërsa, sa i përket aspektit logjistik, theksoi se edhe për dy vjet të ardhshme, nuk ka nevojë për pajisje tjera teknologjike, si dhe aspektin e mundësisë për të qenë prezent në aktivitetet e caktuara, e ka këtë mundësi.

Më tutje, theksoi se korniza e akteve të brendshme ligjore për punët e Agjencisë, është pothuajse e përfunduar.

Kryesuesi falënderoi z. Jashari për raportimin dhe fjalën ua dha anëtarëve të Komisionit për pyetje të mundshme.

Nuredin Ibishi, vlerësoi se Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave, ka bërë të pamundurën për përmbushjen e detyrave dhe kompetencave që ka. Kjo duket edhe nga raportimi i z. Jashari për raportin vjetor të punës. Më tutje, duke iu referuar Raportit të Progresit për Kosovën, për vitin 2015, kur i referohet Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është theksuar nevoja për staf shtesë dhe burimet financiare të cilat tashmë me projektin IPA-I, janë të realizuara deri në një masë. Po ashtu, në Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2015, përmendën zyrtarët përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale, në kuadër të komunave. Për këtë çështje, kërkoi sqarim më të zgjeruar nga ana e z. Jashari. Gjithashtu, kërkoi sqarime shtesë lidhur me specifikat e veçanta për qasjen në dokumente publike.

Ganimete Musliu, theksoi se e shqetëson çështja, sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, lidhur me faturat e energjisë elektrike, faturat e mbeturinave dhe të ujit, që vijnë pa u futur në zarf, sepse këto të dhëna janë të ekspozuara dhe mund të keqpërdoren. A keni ndërmarrë diçka në këtë drejtim dhe kur qytetarët e Kosovës do të marrin fatura në zarf?

Qerim Bajrami, shtroi pyetje si vijon: A ka pasur konkurse për punësim gjatë vitit 2015?

Kryesuesi, duke iu referuar raportit vjetor të Agjencisë, ku ka një rritje të numrit të inspektimeve, shtroi pyetjet si në vijim: Sa janë marrë seriozisht vërejtjet e dhëna nga Agjencia, nga institucionet publike? A është zbatuar në përpikëri ligji për kryerjen e detyrave nga ana e zyrtarëve të Agjencisë dhe a ka pasur ndonjë problematikë lidhur me organizimin e brendshëm të Agjencisë ose ngatërrim kompetencash?

Ruzhdi Jashari, mbikëqyrës kryesor shtetëror, në përgjigje të pyetjeve të shtruara nga deputetët, theksoi se sa i përket çështjes së të punësuarve në Agjenci, kjo është bërë në bazë të organogramit të Agjencisë, ndërsa sa i përket konkurseve për punësim, theksoi se nuk ka pasur konkurse as në vitin 2015 dhe 2016, ndërsa numri i të punësuarve aktualë nuk është i kënaqshëm, pasi që organogrami i paraparë dhe i miratuar me linja buxhetore nuk është i funksionalizuar plotësisht. Më tutje, theksoi se fusha e mbrojtjes së të dhënave personale, është sfiduese. Kosova ende nuk është nënshkruese e Konventës 108, por që ligjet dhe direktivat janë të përfshira në Ligjin për Mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu, është rekomandimi i Agjencisë, që në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, të lëvizet përpara për mundësinë e nënshkrimit të Konventës 108 të Këshillit të Evropës. Po ashtu, Agjencia ka mbledhur disa të hyra, si dhe donacionet, të cilat janë dhënë nga Ambasada e Norvegjisë, banka TEB, linja tjetër e të hyrave, siç është regjistrimi i kontrolluesve, si dhe të hyrat nga masat administrative të ngritura nga Agjencia, si çështje gjyqësore në gjykata.

Ndërsa, në përgjigjeje të pyetjes, lidhur me qasjen në dokumente publike dhe mbrojtjen e të dhënave, theksoi se kjo është një sfidë që duhet tejkaluar dhe se Agjencia nuk ka kompetencë ligjore të mbikëqyrë Ligjin për qasje në dokumente publike. Ndërsa, sa i përket zyrtarëve për mbrojtjen e të dhënave personale, theksoi se janë të emëruar, me përjashtim në pjesën veriore të vendit, ku dy komuna nuk e kanë të përcaktuar zyrtarin për mbrojtjen e të dhënave personale, ndërsa inspektimet janë duke u bërë në pjesën veriore të vendit. Gjithashtu, i është rekomanduar Kuvendit të Republikës së Kosovës, që në sektorët ku ka përpunime të mëdha të të dhënave personale, të vendosen zyrtarët me të vetmen pune. Sa i përket çështjes së faturave që nuk futen në zarf, theksoi se nga ana e Agjencisë janë bërë inspektimet, të cilat kanë reflektuar me procedim në gjykatë për rastin e moszbatimit të vendimit nga ana e KEDS-it. Pasi në rastin e

KEDS-it janë identifikuar një sërë çështjes, sa i përket përpunimit të të dhënave personale, çështja e transferimeve etj. Nga ana e KEDS-it është bërë ankesë në vendimin e Gjykatës Themelore, ndërsa ankesa është proceduar në Gjykatën e Apelit, e cila e ka kthyer dhe është valorizuar vendimi i Gjykatës Themelore. Në vitin 2015, KEDS-i ka qenë i obliguar të kryejë pagesat dhe janë kryer këto pagesa. Agjencia është në vijë të veprimit, pasi duke qenë se jemi agjenci administrative dhe se nuk takojnë aspekte të natyrës penale për Agjencinë.

Ndërsa, në përgjigjeje të pyetjes, se sa janë marrë seriozisht rekomandimet e Agjencisë nga ana e institucioneve kompetente, theksoi se ka institucione që i zbatojnë dhe që nuk i zbatojnë, por kur bëhen inspektive të dyta, ndërmerren veprime nga Agjencia.

Nuredin Ibishi, sa i përket praktikave rajonale, theksoi se jemi në shpërputhje me ta, pasi Ligji për qasjen në dokumente publike, duhet të jetë nën ombrellën e Agjencisë dhe jo të Avokatit të Popullit.

Kryesuesi- A ka pasur tejkalim të kompetencave nga ana e zyrtarëve me pozita udhëheqëse në Agjenci?

Ruzhdi Jashari, mbikëqyrës kryesor shtetëror, theksoi se ka pasur inercion, që në kërkesa të vazhdueshme të tejkalohe disa kompetenca dhe nga ana e Agjencisë janë ndërmarrë veprime që të tejkalohe.

Ganimete Musliu, shtroi pyetjen lidhur me organizimin e një konference ndërkombëtare, për të cilën është njoftuar nga media, dhe me aq sa ka njohuri, nuk janë të ftuar anëtarët e Komisionit. Cili ka qenë qëllimi i organizimit të kësaj konference dhe cilat kanë qenë efektet e saj?

Ruzhdi Jashari, mbikëqyrës kryesor shtetëror, theksoi se konferencën që u theksua nga znj. Musliu, nuk e ka organizuar Agjencia, pasi që është një konferencë lidhur me dhunën kibernetike dhe krimin kibernetikë, por që kjo konferencë nuk është menaxhuar nga Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe nuk kanë marrë pjesë zyrtarë të Agjencisë, pavarësisht që në këtë konferencë ka marrë pjesë z. Mentor Hoxha, anëtar i Këshillit të Agjencisë, por ai ka deklaruar që në cilësinë e kompetencave personale dhe profesionale, ka qenë pjesëmarrës në këtë konferencë.

Qerim Bajrami, shtroi pyetjen, nëse zyrtarët që merren me çështjen e të dhënave personale në institucione të caktuara, janë zyrtarë të institucioneve përkatëse apo të Agjencisë?

Ruzhdi Jashari, mbikëqyrës kryesor shtetëror, theksoi se këta zyrtarë janë të punësuar në institucione, por veçanërisht merren me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të dhënave personale, ku në ligj përshkruhen detyrat e tyre.

Bujar Sadiku, drejtor i përgjithshëm, theksoi se Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, numëron tetëmbëdhjetë zyrtarë, të cilët janë pika të kontaktit me agjencitë dhe institucionet e tjera. Nga viti 2014, nuk ka pasur konkurs në Agjenci, ndërsa duke iu referuar Raportit të Progresit të vitit 2015, rekomandohet shtimi i nevojshëm i kapaciteteve dhe buxhetit. Agjencia, me tetëmbëdhjetë shërbyes civilë, funksionon si e pavarur nga aspekti buxhetor, ndërsa vitin e kaluar janë përcjellë pesë kërkesa, për të cilat është njoftuar edhe Komisioni për

Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, pasi ka nevojë për planifikime të reja buxhetore, në mënyrë që të lirohen zyrtarë të caktuar, të cilët ushtrojnë disa funksione. Ndërsa, sa i përket buxhetit, theksoi se në bazë të kërkesës për shtim të numrit të personelit, është kërkuar edhe rritja e buxhetit.

Kryesuesi falënderoi për paraqitjen e raportit vjetor të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për viti 2015, i cili është një raport gjithëpërfshirës, ku janë paraqitur të gjitha arritjet e këtij institucioni dhe hodhi në votim këtë raport.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në këtë pikë të rendit të ditës, me vota unanime, nxori këtë:

Rekomandim

Të miratohet Raporti vjetor i Punës së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

4. Të ndryshme

Nuredin Ibishi, u bëri thirrje deputetëve nga radhët e opozitës, që të jenë pjesë e seancave parlamentare dhe e komisioneve. Gjithashtu, propozoi që në mbledhjen e radhës, të ftohet për raportim në Komision, ministri i Punëve të Brendshme, si dhe drejtori i përgjithshëm i Policisë, për të raportuar për gjendjen e sigurisë në Kosovë, si dhe në këtë takim të prezantohet draft-plani i Komisionit për mbikëqyrjen e sfidave që dalin nga MSA-ja, në aspektin e sigurisë.

Kryesuesi vlerësoi se propozimi i z. Ibishi është i pranueshëm dhe se në mbledhjen e radhës do të jetë prioritet raportimi i ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Anton Quni, njoftoi për pjesëmarrjen e tij në Konferencën Ndërparlamentare për politikë të përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes dhe politikës së jashtme, e cila është mbajtur në Hagë-Holandë, nga data 6-8 prill 2016, me ftesë të Parlamentit të Holandës, me statusin e veçantë. Në të morën pjesë delegacionet nga parlamentet e 28 vendeve anëtare të BE-së, deputetë nga Parlamenti Evropian, delegacionet nga parlamentet e shteteve me statusin e vendit –kandidat dhe delegacionet nga parlamentet e shteteve, si të ftuar të veçantë, ku mori pjesë edhe delegacioni nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Temat e diskutuara në këtë konferencë, kanë qenë: forcimi i mbrojtjes evropiane nga rreziqet e ndryshme, emigrimin dhe kontrolli i armatimit. Në mbyllje të konferencës, janë amendamentuar përfundimet, që do të ishte mirë që kopjen e njoftimit dhe të përfundimeve, t'i kenë anëtarët e Komisionit.

Kryesuesi njoftoi se gjatë këtij muaji janë thirrur dy mbledhje, njëra e thirrur nga kryetari i Kuvendit dhe tjetra nga nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti, me kryetarët e komisioneve parlamentare, për të parë ecurinë e punës në komisione dhe përshpejtimin e procedimit të projektligjeve. Gjithashtu, ishte edhe një sugjerim nga ana e z. Haliti, që Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, të kërkojë raport lidhur me zbatimin e Ligjit për përgjimin e telekomunikimeve, edhe pse ky projektligj është shqyrtuar dhe amendamentuar nga

Komisioni për Integritet Evropian, dhe si Komision, duhet të kemi parasysh këtë çështje. Nëse nuk ka çështje të tjera për të ngritur, e konsideroj mbledhjen e mbyllur.

Me këtë pikë të rendit të ditës, mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetari i parë i Komisionit,

Fadil Demaku